

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Isa Kelmendi, kryetar, Gyltene Sylejmani dhe Erdogan Haxhibeqiri, anëtarë, në çështjen juridike të paditëses S. Q., nga ..., kundër të paditurës Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, Dardania, p.n. Prishtinë, të cilën e përfaqëson H. I., për shkak të kompensimit të diferencës së pagës, duke vendosur përkitazi me revizionin e të paditurës, paraqitur kundër aktgjyimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.nr.1497/2018 datë 30.5.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 10 tetor 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurës, paraqitur kundër aktgjyimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.nr.1497/2018 datë 30.5.2018.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr. 1451/2016 datë 16.10.2017, aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses S. Q. nga ..., , anulohet aktvendimi i të paditurës Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës nr. ..., i datës 7.3.2012. Detyrohet e paditura që paditëses t'i paguajë ndryshimin e pagës, ndryshimin e bonusit dhe trusti në mes gradës 9 dhe 7 për çdo muaj duke filluar nga data 1.2.2012 deri më 31.12.2014 dhe atë shuma neto e diferencës në pagë është 6.668.00 €, me kamatë e llogaritur në shumë prej 948.61 €, duke filluar nga data 1.2.2012 ku gjithsej diferenca e papaguar së bashku me kamatë përfshijnë shumën prej 7.799.00 € dhe përveç kësaj shume obligohet e paditura që në trustin për sigurim pensional t'i paguaj paditëses kompensimin për shumën e papaguar prej 390.00 € dhe kompensimin për tatim në këtë diferencë në pagë në shumë prej 741.00 € si dhe shpenzimet e procedurës në vlerë prej 180 € në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjyimit e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.nr.1497/2018 datë 30.5.2018, nën pikën I të dispozitivit refuzohet e pathemeltë ankesa e të paditurës Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës – PTK, Sh.a. me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1451/2016 datë 16.10.2017, në pikën I të dispozitivit, në pjesën me të cilën është aprovuar kërkesëpadia e paditëses S. Q., nga ..., dhe është detyruar e paditura që paditëses t'i paguajnë ndryshimin e pagës, ndryshimin e bonusit dhe trustit në mes të gradës 9 dhe 7 për çdo muaj duke filluar nga data 1.2.2012 deri më 31.12.2014 dhe atë shuma neto e diferencës në pagë është 6.668,00 €, me kamatë e llogaritur në shumë prej 948.62 €, duke filluar nga data 1.2.2012

ku gjithsej diferenca e papaguar së bashku me kamatën përfshinë shumë prej 7.799 € dhe përveç kësaj shume obligohet e paditura që në trustin për sigurim pensional t'i paguajë paditëses kompensimin për shumën e papaguar prej 390,00 € dhe kompensimin për tatim në këtë diferencë në pagë në shumë prej 741.00 €, si dhe shpenzimet e procedurës në vlerë prej 180 € në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë, vërtetohet. Nën pikën II të dispozitivit anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, C.nr. 4051/2016 datë 16.10.2017, nën pikën I të dispozitivit në pjesën e kërkesëpadisë me të cilën është aprovuar kërkesëpadia e paditëses S. Q. nga ..., dhe është anuluar aktvendimi i të paditurës nr. ..., i datës 7.3.2012 për shkak të çështjes së gjykuar-res iudicata.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë e paditura me kohë ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të LPK dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që të ndryshohen të dy aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët dhe kërkesëpadia e paditëses të refuzohet si e pabazuar ose të prishen dhe lënda të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), shqyrtoi aktgjykimin e goditur me revizion dhe gjeti se:

Revizioni i të paditurës është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se sipas kontratës së punës nr. ..., datë 20.10.2011, të lidhur në mes të paditëses dhe të paditurës si punëdhënëse për kohë të pacaktuar, paditësja ka themeluar marrëdhënien e punës në vendin e punës zyrtar i llogarive për korporata në Njësinë – Telekom i Kosovës në Prishtinë ndërsa të njëjtës i caktohet paga bazë për punën të cilën e kryen në lartësi të gradës 9 sipas nenit 5 të kësaj kontrate. Mirëpo, me aktvendimin e të paditurës nr. ..., datë 7.3.2012, paditëses i caktojnë të ardhura personale në lartësi të gradës 7 duke filluar prej datës 1.2.2012 e tutje, duke konsideruar këtë aktvendim si pjesë përbërëse e kontratës së punës me këshill juridike se ky aktvendim mund të ankimohet në komisionin e ankesave në afat prej 8 ditësh. Paditësja është ankuar kundër këtij aktvendimi dhe njëherit ka parashtruar padi në gjykatë për mbrojtjen e të drejtave nga marrëdhënia e punës. Zvogëlimi i gradës së pagesës për paditësen prej 9 në 7 gradë sipas të paditurës është bërë në bazë të shkresës së ministrit B. B., të datës 6 dhjetor 2011 drejtuar kryetarit të Bordit të Drejtorëve të paditurës me qëllim të ngritjes së vlerës së përgjithshme të PTK-së me të cilën shkresë është kërkuar që niveli i shpenzimeve operative vjetore duhet

të reduktohen për vitin 2012 në jo më shumë se 20%. Ndryshimin e lartësisë së pagës me rastin e zvogëlimit të gradës të paditëses gjykata e vërtetoi me ekspertizë financiare.

Duke u bazuar në këtë gjendje të vërtetuar faktike gjykata e shkallës së parë ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses duke vendosur si në dispozitiv të aktgjyqimit të saj. E njëjta gjykatë ka gjetur se vendimi kontestues për ulje të gradës është i kundërligjshëm meqë paditësja dhe e paditura janë në raporte kontraktuale sipas kontratës së punës dhe e njëjta kontratë nuk mund të ndryshohet me vullnetin e vetëm njërës nga palët. Sipas nenit 55 të Ligjit të Punës paditësja ka pasur të drejtë në pagë të përcaktuar me kontratën e punës në pajtim me ligjin, kontratën kolektive dhe aktin e brendshëm të punëdhënësit.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore e ka refuzuar ankesën e të paditurës dhe ka vërtetuar aktgjyqimin e gjykatës së shkallës së parë në pjesët e dispozitivit me të cilin është detyruar e paditura që paditëses t'i paguajë ndryshimin e pagës, bonusit dhe trustit në mes të gradës 9 dhe 7 për çdo muaj duke filluar nga data 1.2.2012 deri më 31.12.2014 me kamatë e më afërsisht të përshkruar në dispozitiv të aktgjyqimit të goditur. Njëherit nën pikën II të dispozitivit e anulon aktgjyqimin të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr. 1451/2016 datë 16.10.2017, nën pikën I të dispozitivit në pjesën e kërkesëpadiës me të cilën është aprovuar kërkesëpadija e paditëses dhe është anuluar aktvendimi i të paditurës nr. ..., i datës 7.3.2012 për shkak të çështjes së gjykuar pasi që më parë me aktgjyqim të formës së prerë e të njëjtës gjykatë C.nr.1525/2012 datë 23.5.2013 për këtë çështje njëherë është vendosur.

Në gjendje të tillë faktike Gjykata Supreme e Kosovës pranon si të bazuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së dytë dhe asaj të parë lidhur me aprovimin si të bazuar të kërkesëpadiës së paditëses përkitazi me kompensimin e diferencës në pagë për paditësen prej 9 në 7 pasi që aktgjyqimet e këtyre gjykatave nuk janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore e as me zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Për më tepër gjykata e revizionit vlerëson e aktgjyqimet e lartcekura nuk janë përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore në të cilat gjykata e revizionit kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Objekt shqyrtimi në gjykatën e revizionit ishin pretendimet e revizionit përkitazi me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës nga neni 182.2 pika (n) të LPK. Gjykata e revizionit vlerëson se këto aktgjyqime nuk përfshihen me të meta e paqartësi as në

dispozitiv e as në arsyetimin e tyre, përkundrazi të njëjtat janë të qarta, nuk përmbajnë të meta e paqartësi, në arsyetim janë dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me fakte juridikisht të vlefshme për gjykim të drejtë të kësaj çështjeje juridike të cilat janë të pranuar plotësisht edhe nga kjo Gjykatë, andaj këto pretendime të revizionit u refuzuan si të pabazuara.

U refuzuan si të pabazuara edhe pretendimet tjera të revizionit për shkelje qenësore procedurale nga neni 182.1 lidhur me nenin 190 e 191 të LPK, të cilat sipas të paditurës qëndrojnë në atë se gjykata e shkallës së dytë me rastin e vendosjes sipas ankesës e të paditurës nuk ka mbajtur seancë gjyqësore për shqyrtimin e çështjes në të cilën është dashur të thirren edhe palët. Këto pretendime të revizionit janë të pabazuara për faktin se gjykata e shkallës së dytë nuk ka gjetur se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është mbështetur në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht apo në mënyrë jo të plotë, kështu që duke vlerësuar edhe se në procedurën ankimore nuk janë paraqitur fakte dhe prova të reja edhe gjykata e shkallës së dytë nuk ka pasur për obligim ta mbajë seancën gjyqësore në prezencën e palëve lidhur me ankesën e të paditurës.

Qëndron fakti se në rastet tjera të ngjashme gjykata e shkallës së dytë në kolegje të ndryshme ka vendosur ndryshe, mirëpo secili aktgjykim i gjykatës së shkallës së dytë në mënyrë të veçantë mund t'i nënshtrohet procedurës sipas revizionit me çka përmes vendimit gjyqësor të gjykatës së revizionit eliminohet vendim marrja e ndryshme e gjykatës së shkallës së dytë për situata të njëjta.

Objekt shqyrtimi në gjykatën e revizionit ishin edhe pretendimet e revizionit për zbatim të gabuar të së drejtës materiale nga neni 78 dhe 79 të Ligjit të Punës. Sipas të paditurës padia e paditëses në pjesët kur është kërkuar anulimi i vendimit për ulën e gradës është i vonuar. Gjykata Supreme vlerëson se në këtë rast paditësi nuk është vonuar me paraqitjen e padisë ngase kontesti kryesisht ka të bëjë me pagesën e diferencës së pagës për shkak të një vendimi arbitrar të kundërligjshëm të paditurës për zvogëlimin e pagës për të cilën kërkesë në kuptim të nenit 87 të Ligjit të Punës afati i parashkrimit është 3 (tri) vite e jo siç pretendohet në revizion se afati për paraqitjen e padisë për paditësen duhet të llogaritet në pajtim me nenin 78 dhe 79 të Ligjit të Punës.

Për më tepër Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se i punësuari ka të drejtë në pagë e cila i caktohet të punësuarit me kontratë të punës në pajtim me Ligjin e Punës, kontratën kolektive dhe aktin e brendshëm të punëdhënësit. Paga e paditëses sipas kontratës së punës ka qenë sipas gradës 9. Prandaj, ulja e pagës nën këtë gradë është në

kundërshtim me dispozitat e kontratës dhe të Ligjit të Punës. Kërkesa e aksionarit Qeverisë së Republikës së Kosovës – Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik lidhur me shpenzimet e uljeve operative të e paditura në raport me të hyrat e përgjithshme nuk mund të jetë bazë për uljen e pagës paditëse pasi që në rekomandimin e Qeverisë nuk janë precizuar se cilat shpenzime operative e as që thuhet në atë rekomandim për uljen e pagave dhe se e paditura është dashur të paraqet një plan të detajuar operativ lidhur me uljen e shpenzimeve duke precizuar ato, por një provë e tillë nga ana e të paditurës nuk është paraqitur, andaj thëniet e revizionit në këtë drejtim janë të pabazuara. Nuk ka prova se e paditura ka bërë ndërhyrje në aktet normative të saj lidhur me zvogëlimin e gradave nuk mund të bëhet kjo me një vendim të njëanshëm të drejtorit menaxhues të paditurës. Njëherit është i pabazuar edhe pretendimi ankimor sa i përket llogaritjes së kamatës. Kjo për arsye se ekspertja financiare ka bërë llogaritjen e kamatës në diferencën e pagave të papaguara për periudhën kohore prej datës 1.2.2012 deri më 31.12.2014 në pajtim me nenin 277 të LMD ku është paraparë kamata të cilën e paguajnë bankat vendore si për deponimet në kursim në afat prej 1 (një) vit e pa destinim të caktuar dhe nuk ka arsye të dyshohet me njëanshmërinë e ekspertit. Prandaj, në kontest më lart të cekura pretendimet e parashtruara në revizion paraqiten si të pabazuara.

Për arsyet e paraqitura më lartë dhe në pajtim me nenin 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr. 315/2018, më 10 tetor 2018

Kryetari i kolegjit,

Isa Kelmendi